

# Petrit Çeno




## KRYETAR I GJYKATËS SË APELIT DURRËS

### Deklaratat e analizuara:

#### 15 Deklarata të analizuara

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri Periodik/Vjetor 2017)

## Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2017




59.8 herë Rritja e Pasurisë Bruto

+ 2,522,012 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë


## Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë


### Likuiditete në Bankë




### Likuiditete në Cash




### Pasuritë e Paluajtshme



### Pasuritë e Luajtshme



### Pjesë në Kapital



## Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

Të Ardhurat 2004-2017	Shuma në Lekë	Raporti në %
Paga dhe shpërblime nga funksioni	18,418,263	26.8%
Të ardhura nga paga e familjarëve	9,422,294	13.7%
Të ardhura nga biznesi i bashkëshortes	19,585,207	28.5%
Të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme	21,321,690	31.0%
<b>Total</b>	<b>68,747,454</b>	<b>100%</b>



## Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 14 vite rezultoi:

**1 Me probleme**  
**13 Pa probleme**

Subjekti rezulton me probleme mosjustifikimi të pasurisë në vitin 2011 në shumën 825,434 lekë. Ai deklaron investim në pasuri të paluajtshme me burim kursimet e viteve të mëparshme, të cilat janë të pamjaftueshme për të mbuluar investimin.

Në deklarimin e vitit 2003, subjekti deklaron pasuri të paluajtshme: tokë bujqësore në emër të bashkëshortes me sipërfaqe 6,000 m<sup>2</sup>, përfituar nga ndarja e tokës bujqësore, ndërsa për një apartament me sip.78m<sup>2</sup> dhe një banesë 2+1 nuk ka të dhëna për çmimin e blerjes.

Sipas deklarimit të vitit 2003, bashkëshortja e subjektit Mimoza Çeno është bashkëpronare 1/9 në një agjensi doganore në Portin e Durrësit - nuk ka të dhëna mbi kapitalin apo investimin e bërë, por subjekti deklaron të ardhura vit pas vit në formë fitimi dhe si administratore.

Në vitin 2009, bashkëshortja e subjektit, në bazë të kontratës së sipërmarrjes datë 21.01.2009 ka dhënë truall për ndërtim me sipërfaqe 2775m<sup>2</sup>, në përfundim të së cilës do të përfitohej 23% e sipërfaqes së ndërtimit, ose siç është specifikuar me aneksin e kontratës datë 14.11.2009 pjesa takuese prej 708,84m<sup>2</sup> ndërtim dhe 150m<sup>2</sup> terracë. Në vitin 2011 janë deklaruar disa pronar (dyqan, garazh, apartamente) me sip. gjithsej 618 m<sup>2</sup>, përfituar si rezultat i kësaj kontrate sipërmarrje, të cilat janë shitur pjesërisht.

Në vitin 2016 bashkëshortja ka kaluar shumën 60,000 euro në formë investimi në shoqërinë "Heavy Industries" shpk, për llogari të pjesës takuese të djalit në këtë shoqëri në masën 50% - ky biznes është deklaruar në vitin 2011 nga djali i subjektit si bashkëpronar me kapital fillestar 100,000 lekë dhe në vitet në vazhdim nuk është deklaruar rritje/ndryshim kapitali apo fitim nga aktiviteti i këtij biznesi.

Gjithashtu në vitin 2012 është marrë një kredi nga Banka Societe Generale në shumën 80,000 euro pa objekt kontrate - në vitin 2014 kjo kredi ka kaluar në llogari të biznesit të djalit dhe shlyerja e kësaj kredie bëhet nga të ardhurat e këtij biznesi.

Gjendja Cash që rezulton në fund të periudhës deklaruese është 5,147,204 lekë, disa herë më e lartë se kufiri i lejuar për t' u mbajtur Cash prej 1,500,000 lekësh.